



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 849 Prot.

Tiranë, më datë 16.06.2023

**VENDIM**  
**Nr. 326, datë 16.06.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, Vendim Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për Përcaktimin E Procedurave Për Hulumtimet Arkeologjike, Të Kushteve Të Posaçme Të Lëshimit Të Lejes, Dokumenteve Shoqëruese, Si Dhe Procedurave Për Shqyrtimin Ose Anulimin E Lejes Për Kryerjen E Hulumtimeve Arkeologjike” dhe “Rregullorja e arkeologut”, me Vendim Nr.2, datë 30.01.2009 e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.06.2023:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes së projektit kërkimor-shkencor “Arkeologji e peizazhit në zonën Tepelenë – Memaliaj”, me bashkëdrejtues projekt Dr. Sabina Veseli, Prof. Asoc. Dr. Eduard Shehi, Dr. S. Fiorello dhe Dr. E. Pitt Sweet Collage, deri në momentin e:
  - Depozitimit të autorizimit të personit që ka autorizuar elektronikisht projektin;
  - Depozitimit të koordinatave të zonës ku do të kryhet hulumtimi arkeologjik;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

